

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Verniku Solar” sh.p.k.

Sot, më datë 01/09/2025 në Tiranë, Shqipëri, u vendos themelimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me ortakë:

Dritsol Shpk, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (“QKB”) me Numër Unik Identifikimi M52006023U, me seli në adresën: Rruga “Ferit Xhajko”, pasuria nr.7/287-N14, Vol 9, Faqe 167, Zona Kadastrale 8340, Tiranë, përfaqësuar rregullisht nga Administrator Leonora Merja, këtu e në vijim referuar si (“Ortaku 1);.

EUROSOL ENERGY CONSTRUCTION shpk, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (“QKB”) me Numër Unik Identifikimi M36614007K, me seli në adresën: “Rruga H.Bajraktari, Nr.pasurie 2/261+1-16, zona kadastrale 8594 4001”, Shkodër, përfaqësuar rregullisht nga Administratori Ormir Shqarri, këtu e në vijim referuar si (“Ortaku 2“)

Neni 1
Emërtimi

- 1.1 Emërtimi i shoqërisë është **“Verniku Solar” sh.p.k**, këtu më poshtë e quajtur **“Shoqëria”**.
Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 1.2 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 1.3 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin.

Neni 2
Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën:
Rruga “Dëshmorët e Devollit”; pasuria nr.5/378 N2 ,Vol 18, Faqe 38, Zona Kadastrale 1187, Bilisht, Devoll.



- 2.2 Shoqëria mund të hap degë dhe zyra përfaqësimi në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

Neni 3

Objekti

- 3.1 Objekti i Shoqërisë do të jetë:

1. Të operojë/të kryejë investime, në fushën e prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme/parqe fotovoltaike. Shoqëria gjithashtu mund të marrë pjesë si ortak ose aksionar në shoqëri të tjera që operojnë në të njëjtën fushë, në vend ose jashtë vendit, si dhe të zotërojë, administrojë dhe zhvillojë projekte energjetike nëpërmjet shoqërive të posaçme.
2. Çdo veprimtari tjetër e lejuar me ligj.

Neni 4

Kohëzgjatja

- 4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

Neni 5

Kapitali Themeltar dhe Ortakët

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100'000 (njëqind mijë) lekë;

- 5.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 2(dy) kuota, që paguhet dhe zotërohet nga ortakët e mëposhtëm:

- **Dritsol Shpk**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB") me Numër Unik Identifikimi M52006023U, me seli në adresën: Rruga "Ferit Xhajko", pasuria nr.7/287-N14, Vol 9, Faqe 167, Zona Kadastrale 8340, Tiranë, përfaqësuar rregullisht nga Administrator Leonora Merja, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotërues i 1 (një) kuote të kapitalit me vlerë nominale 51000 (pesëdhjetë e një mijë) lekë që përfaqëson 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- **EUROSOL ENERGY CONSTRUCTION shpk**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB") me Numër Unik Identifikimi M36614007K, me seli në adresën: "Rruga H.Bajraktari, Nr.pasurie 2/261+1-16, zona kadastrale 8594 4001", Shkodër, përfaqësuar rregullisht nga Administratori

Ormir Shqarri, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotërues i 1 (një) kuote të kapitalit me vlerë nominale 49000 (dyzetë e nëntë mijë) lekë që përfaqëson 49% (dyzetë e nëntë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

- 5.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë.
- 5.4 Përgjegjësia e Ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributit në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 6

Transferimi i Pjesëve-Kuotave dhe Asambleja e Përgjithshme

- 6.1 Pjesët e kapitalit i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.
- 6.2 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e këtij Statuti, janë të detyrueshme për të Ortakët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime.

Neni 7

Administratori

- 7.1 Administratori i parë i Shoqërisë është:
Z. Dritan Merja, i biri i Ylli, i biri i Ylli, i datëlindjes 04/02/2002, lindur në Tiranë dhe banues në adresën Rruga: Njesia Administrative nr.8, Rruga "Ferit Xhajko", objekti me nr.pasurie 7/675-G31, zona kadastrale 8340, Tiranë, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit Id me nr.personal K20204040U, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr.cel 0692045160 dhe e-mail Dritanmerja.cso@gmail.com
- 7.2 Mandati i Administratorit është për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, i rinovueshëm dhe nëse është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.
- 7.4 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori i cili është përgjegjës personalisht për shkelje të ligjit dhe të Statutit dhe për gabimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

Neni 8

Viti Financiar



- 8.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.
- 8.2 Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2025.

Neni 9
Të ndryshme

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe.

9.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin e akteve dhe dokumenteve si më lartë, versioni në shqip do të jetë i vetmi version ligjërish detyrues.

Ky Akt Themelimi u nënshkrua lirisht nga palët duke shprehur vullnetin e lirë dhe të plotë.

ORTAKU

ORTAKU

Për “Dritsol” Shpk

Për “EUROSOL ENERGY CONSTRUCTION” shpk

Leonora Merja

Znj. Leonora Merja



Z. Ormir Shqarri

Z. Ormir Shqarri

